

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

ANKESË

Një ankesë kundër: Universitetin Publik Kadri Zeka

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. Nr.941-172148-221

Sa i përket tenderit "Pastrimi dhe mirëmbajtja e Objektivit Brenda dhe jashtë të Universitetit Kadri Zeka Gjilan"



1. Identifikimi i ankuesit*

Mobile Sanitary Services (MSS) Shpk-Prishtinë

Prishtinë

~~(Emri i kompanisë)~~

Behxhet Haxholli

18/07/2017

(Data e parashtrimit të ankesës) (Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

Vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me dt:10.07.2017

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga moment i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

*** AK gjatë vlerësimit të këtij tenderi ka bërë shkelje të këtyre dispozitave ligjore:**

1. Nenin 1 të LPP-së
2. Nenin 6 të LPP-së
3. Nenin 7 të LPP-së
4. Neni 59 të LPP-së
5. Neni 60 të LPP-së

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar kërkojmë që ta shqyrtoni drejtë dhe në mënyrë objektive këtë ankesë, pasi që është rekomanduar për kontratë konzorciumi i papërgjegjshëm Krasniqi Shpk&Schafberger.

Këtë pretendim e mbështesim në faktet të cilat ne i kemi marr kopje dhe që i kemi vërtetuar gjatë qasjes në dokumentacionin e këtij tenderi.

Konzorciumi i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse dorëzimi i ofertave është bërë me dt:05.06.2017 kurse vërtetimi i ATK i njërit anëtar të konzorciumit Schafberger është i dt:02.02.2017 çka do të thotë se ky vërtetim është më i vjetër se tre muaj, kurse vërtetimi i anëtarit tjetër të konzorciumit Krasniqi është edhe më i vjetër, i dt:05.01.2017, këto dokumente ne i kemi shikuar dhe bërë kopje gjatë qasjes në